



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**AGJENCIA E MBROJTJES SË KONSUMATORIT**  
**NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.,

Data \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2026

**PROCESVERBAL-Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURES: "Blerje karburanti"**

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 09100000-0.**

**Vlera e Fondit Limit: 1.683.333 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke pa TVSH**

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave: 10 (dhjetë ditë)** sipas Nenit 49, pika 3 e Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", ku përcaktohet se "*Afati për pranimin e ofertave në këtë procedurë prokurimi është jo më pak se 10 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës.*"

**Procedura e këtij prokurimi është:** Procedure e Hapur e Thjeshtuar/ Marrëveshje kuadër

**Kohëzgjatja në muaj:** 12 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të të prokurimit prok publik", autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.*

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, pika 2/c e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpermjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK. Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar dhe nenit 40 pika 4 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur e thjeshtuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të ulët se 20 % të fondit limit, rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor i përmbushjes së kontratës dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik. Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor në bindje se Operatori ekonomik fitues përmbush dhe realizon me sukses kontratën objekt prokurimi.

**2.3.2** OE duhet të disponojë Licencë për stacion shitje karburantesh, gazit të lëngshëm të naftës për automjete dhe vajra lubrifikantë lëshuar nga pushteti vendor, **dhe/ose** Licencë për ushtrimin e aktivitetit (tregëtim karburantesh) të lëshuar nga QKB:

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma ”a”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ”Per perpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftes, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, pasi kjo është një procedurë shumë specifike, vetëm për blerje karburanti, lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil), e cila kërkon leje të veçantë për tregtimin e këtij malli.

**2.3.3** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Fletë-Analizë për produktet e kërkuara: - Gazoil (Diesel 10 ppm ULSD), S SH EN 590:2022 ose ekuivalente lëshuar nga organi kompetent, ose nga një laborator shqiptar i çertifikuar, ose i huaj (n.q.s është laborator i huaj, duhet e përkthyer në shqip dhe e noterizuar), që vërteton cilësinë e produktit objekt i këtij prokurimi, sipas standardeve të përcaktuara në pajtueshmëri me specifikimet teknike, e lëshuar jo më parë se 6 muaj nga data e shpalljes së procedurës.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligji nr.8450, datë 24.02.1999 “Për Përpunimin, për Transportin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe Nënprodukteve të tyre, i ndryshuar”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi me karburant për automjetet të cilat duhet të funksionojnë sipas specifikimeve teknike të tyre, duhet të dëshmojnë që produkti ka minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që cilësia e mallit ndikon drejtpërdrejt në automjetet do të përdoret pasi nëse produkti nuk do të plotësonte minimalisht karakteristikat teknike të kërkuara ai do dëmtonte automjetet.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet te paraqesë një vertetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standardeve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për vitin e fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma ”c”, dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Rrepublicën e Shqipërisë”, si dhe ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, për transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofron produktin me cilësi duke respektuar standartet Ligjore. Vërtetim i lëshuar nga ky institucion siguron

Autoritetin Kontraktor që ofrohet furnizim me karburant cilësor si dhe operatori ekonomik ofertues zbaton kushtet e parashikuara në lejet apo autorizimet përkatëse për ushtrimin e aktivitetit.

Ky kriter është vendosur për të siguruar Autoritetin Kontraktor që Operatori Ekonomik për periudhën e kërkuar ka ushtruar aktivitetin konform ligjeve dhe rregullave që ato përcaktojnë për tregtimin e karburanteve, në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”.

### 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me:

- Vërtetim Teknik të lëshuar nga ISHTI ose nga organe të miratuara të vlerësimit të konformitetit.
- Policë Sigurimi për përgjegjësinë e palëve të treta.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a.) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, në ligjin nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion“. Në lidhje me kriterin e lejes mjedisore kjo kërkesë është referuar ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, i ndryshuar me ligjin nr. 60/2014, “Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 152 date 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me kërkesat mjedisore duke garantuar reduktimin, minimizimin apo shmangin e ndikimeve në mjedis të instalimeve ndotëse, duke respektuar standartet kombëtare. Kërkesa për pajisjen e OE me police sigurimi për përgjegjësinë e palëve të treta është vendosur në zbatim të VKM Nr.1047, datë 16.7.2008, pika 7, ku përcaktohet “Shoqëritë e pajisura me leje tregtimi ose autorizim, brenda 30 ditëve nga data e pajisjes, duhet të kryejnë sigurimin e përgjegjësishë ligjore për dëmet, që mund t’u shkaktohen palëve të treta, për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë”

### 2.3.6 Operatori Ekonomik ofertues duhet të deklarojë me shkrim se garanton dhe merr përsipër furnizimin e pandërprerë me karburant çdo ditë të javës brenda 24 orëve në të paktën 4 (katër) pika karburanti brenda qytetit të Tiranës në pronësi ose me qera apo në cdo formë tjetër bashkëpunimi, të cilat do të shërbejnë për furnizimin e automjeteve të AK. Në deklaratë duhet të përcaktohet qartë vendndodhja e pikave të karburantit.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Në konceptimin e këtij kriteri AK ka pasur në konsideratë numrin e automjeteve të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës si dhe itineraret ditore që ato kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale që ato kanë e ndodhin brenda hapësirës juridike të Bashkisë së Tiranës, nga ku evidentojme që numri minimal prej 4 stacionesh tregtimi me pakice të

karburanteve në Bashkinë e Tiranës është vendosur duke marrë parasysh shtrirjen territoriale të kësaj bashkie, si bashkia më e madhe në vend dhe numrin e autoriteteve që e kanë seline dhe operojnë kryesisht në hapësirën territoriale të kësaj bashkie.

Per sa me lart, AK gjykon se kërkesa e mësipërme është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

### **Argumentim për hartimin e specifikimeve teknike:**

Hartimi i specifikimeve teknike të Gazoilit (Diesel 10 ppm ULSD) është bërë në përputhje me Standardet Shtetërore në fuqi të publikuara aktualisht në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardeve, Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP, për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Karburanti”.